

# Përfitimet ekonomike nga investimet në efijencë të energjisë në Kosovë



Përfitimet ekonomike nga  
investimet në efikasitet të  
energjisë në Kosovë

Korrik 2023

**Deklaratë mohimi:**

Ky hulumtim u mundësua nga  
Agjencia Suedeze për Zhvillim e  
Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).  
Përmbajtja është përgjegjësi e  
Institutit GAP dhe nuk pasqyron  
doemos pikëpamjet e Sida.

— **Përmbajtja**

Shkurtesat	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Sektori i Energjisë në Kosovë	5
2. Kriza energjetike në Kosovë dhe masat e qeverisë	7
3. Financimi i projekteve të EE dhe ndikimi në ekonominë e Kosovës	9
3.1. Investimet në Sektorin Publik përgjatë viteve 2016–2022	9
3.2. Investimet në Sektorin Privat përgjatë viteve 2016–2022	11
4. Strategjia e Energjisë, legjislacioni dhe objektivat strategjike	12
4.1. Ndikimi i investimeve në efikasitet të energjisë në punësim dhe formalizim të tregut	14
Rekomandimet	17
Aneksi	18

## Shkurtesat

<b>AKEE</b>	Agjencioni Kosovar për Efiçencën e Energjisë
<b>BPV</b>	Bruto Produktit Vendor
<b>BRE</b>	Burimet e Ripëtërishme të Energjisë
<b>DEE</b>	Direktiva për Efiçencën e Energjisë
<b>DPEN</b>	Direktiva për Performancën Energjetike në Ndërtesa
<b>EE</b>	Efiçienca e Energjisë
<b>ESCO</b>	Kompanitë për Shërbime Energjetike
<b>FKEE</b>	Fondi Kosovar për Efiçencën e Energjisë
<b>HUPX</b>	Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike
<b>IPA</b>	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit
<b>KEDS</b>	Kompania Kosovare për Distribim me Energji Elektrike në Kosovë
<b>KEK</b>	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
<b>KESCO</b>	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike
<b>KIESA</b>	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
<b>Kne</b>	Kilogram naftë ekuivalente
<b>Ktoe</b>	Kiloton naftë ekuivalente
<b>MCC</b>	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>MFK</b>	Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>SKE</b>	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2022–2031
<b>ZRRE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

## Përmbledhje ekzekutive

Kosova ka intensitetin më të lartë të energjisë në Evropë. Sektori rezidencial është konsumuesi më i madh i energjisë në Kosovë, që do të thotë se është edhe sektori me potencialin më të lartë për kursim të energjisë. Zbatimi i programeve të efijencës së energjisë sjellë përfitime të shumta në këtë aspekt. Përveç përfitimeve direkte në uljen e konsumit të enërgjisë, atyre shumëzuese makroekonomike ndërmjet ndikimit në përmirësimin e Bruto Produktit Vendor (BPV), ofrimi i programeve të tilla siguron një fluks të qëndrueshëm punësimi në industrinë e ndërtimit, rritjen e aktivitetit ekonomik në industrinë e ndërtimit dhe renovimit, me rritje të të hyrave private dhe publike, rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit energjetik, etj.


Përgjatë viteve 2016–2022 janë zbatuar disa projekte qeveritare në fushën e efijencës së energjisë, mirëpo këto projekte fokus të veçantë kanë pasur sektorin publik, ndriçimin publik dhe në masë më të vogël sektorin rezidencial dhe industrinë. Përgjatë këtyre viteve janë zbatuar projekte që arrijnë vlerën e kursimit në 8.01 ktoe (kiloton naftë ekuivalente) për sektorin publik, me kosto investive prej 48.8 milionë euro. Ndërsa në sektorin rezidencial dhe privat/komercial përgjatë viteve 2016–2022, me ndihmën e projektit të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), bashkëfinancimit nga konsumatorët dhe kredive favorizuese të gjelbërta nga bankat komerciale, janë arritur kursime në vlerë prej 21.6 ktoe, me kosto investive prej 130 milionë euro. Si rezultat i zbatimit të projekteve të lartëpërmendura është arritur kursimi prej 29.61 ktoe (344.36 GWh) apo rreth 1.77% e konsumit të energjisë për vitin 2022, dhe ka rezultuar në kursim vjetor prej 29 milionë euro nga importet në kohë stabile (ku çmimi i tregut është 85 euro/MWh) apo 103 milionë euro në periudhën e krizës energjetike (ku çmimi ka arritur vlera mbi 300 euro për MWh). Për vitin 2023, qeveria nëpërmjet mekanizmave të zhvilluar nga Ministria e Ekonomisë (ME) dhe Fondi për Efijencë të Energjisë ka alokuar buxhetin prej 40 milionë euro për zbatimin e projekteve që kanë qëllim të arrijnë kursimin prej 11.47 ktoe.

Me qëllim të prioritizimit të investimeve në sektorin e energjisë dhe veçanërisht në efijencën e energjisë (objektivi strategjik kombëtar 3), qeveria ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë (SKE) 2022–2031. Nëpërmjet kësaj strategjie është përcaktuar objektivi ambicioz i kursimeve kumulative prej 283 ktoe deri në vitin 2031. Përderisa dokumentet strategjike dhe legjislative janë të gjitha të definuara, mungesa e zbatimit të duhur dhe mekanizmave mbështetës e ka zgjatur procesin e investimit në efijencë të energjisë (EE). Për zbatimin e suksesshëm të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe targeteve të EE, qeveria duhet të ripërcaktojë fushëveprimin e Fondit të Efijencës së Energjisë, të zhvillojë mekanizmat private të financimit dhe të rrisë kapacitetet zbatuese të sektorit privat. Me zbatimin e këtyre politikave mund të krijohen më shumë se 4,000 vende pune në sektorin e EE-së, si dhe nga kursimi i kapitalit dhe redistribuimi i të hyrave të krijohen edhe rreth 1,382 vende pune në sektorët e tjerë për një afat kohor prej 20 vite, aq sa është jetëgjatësia e masave. Për më tepër, bashkëfinancimi qeveritar ndikon edhe në formalizimin e tregut të punës si dhe rritjen e kualitetit të shërbimeve të ofruara.

# 1. Sektori i Energjisë në Kosovë

Intensiteti i energjisë në Kosovë është ndër më të lartët në Evropë. Konkretisht, për të realizuar vlerë të shtuar në ekonomi prej 1,000 euro nevojiten 467 kilogram naftë ekuivalente (kne), sasi kjo katër herë më shumë se mesatarja e Bashkimit Evropian (BE) për vitin 2021 (shiko figurën 1).<sup>1</sup> Edhe pse shpenzimi i energjisë për kokë banori është përafërsisht sa gjysma e mesatares së BE-së, mesatarja e BPV-së për kokë banori është shumë më e ulët se mesatarja e BE-së. Ky problem ka qenë mjaft evident gjatë krizës së fundit energjetike, kur ekonomia e Kosovës u ndikua dukshëm nga ngritja e çmimeve, duke përfshirë pasigurinë, rritjen e inflacionit, si dhe ndërprerjen në furnizim me energji elektrike.

**Figura 1.** Intensiteti i Energjisë për BPV në Evropë, 2021-2022



Burimi: Eurostat, 2022


Në vitin 2021, konsumi i energjisë primare<sup>2</sup> ishte 2,890 ktoe dhe konsumi final i energjisë<sup>3</sup> ishte 1,666 ktoe. Sektori rezidencial (amvisëritë) është konsumuesi më i madh i energjisë në Kosovë, i cili pasohet nga transporti, industria, sektori i shërbimeve dhe në fund sektorë si bujqësia etj. (figura 2). Ndërtesat përbëjnë 40% të konsumit final të energjisë në Kosovë<sup>4</sup>. Me kërkesën për energji e cila pritet të ketë rritje mesatare vjetore prej 4.6%, përmirësimi i efiçencës së energjisë (EE) në ndërtesa është bërë një nevojë urgjente në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së ambientit.

<sup>1</sup> Eurostat. Intensiteti i Energjisë në Evrope 2021. Burimi: <http://bit.ly/3EZdsyD>, qasur më 25.01.2023,

<sup>2</sup> Konsumi i energjisë duke përfshirë edhe humbjet teknike, komerciale si dhe konsumin e vetë sektorit të energjisë.

<sup>3</sup> Konsumi Energjisë që faturohet te konsumatorët fundor dhe nuk përfshinë humbjet teknike/ komerciale.

<sup>4</sup> ZRRE, Raporti Vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3lShQR4>, qasur më 30.01.2023

**Figura 2.** Konsumi final i energjisë sipas sektorëve

Burimi: Eurostat, 2022

Një sërë politikash dhe rregulloresh janë miratuar nga BE për të reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimin e CO<sub>2</sub> në shtetet anëtare të BE-së dhe, meqenëse Kosova është anëtare e Komunitetit të Energjisë dhe anëtare potenciale e Bashkimit Evropian, ajo duhet të ndjekë këto rregullore. Për të përmirësuar eficiencën e energjisë në ndërtesa dhe për të reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimet e CO<sub>2</sub>, Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë ka përshtatur Direktivën për Eficiencë të Energjisë (DEE) dhe Direktivën për Performancën Energjetike në Ndërtesa (DPEN), të cilat gjithashtu përfshijnë Direktivën për etiketim të energjisë dhe rregulloret relevante të BE<sup>5</sup>.

DEE dhe DPEN theksojnë rëndësinë e përmirësimit të eficiencës së energjisë në ndërtesa, duke përfshirë renovimin e ndërtesave ekzistuese. Drejtuesi kryesor i DEE, DPEN dhe direktivave të tjera është arritja e targetit të kursimit të energjisë për 15.7% deri në vitin 2031, dhe në të njëjtën kohë janë udhërrëfyes për arritjet ambientale afatgjata deri në 2050 në energji dhe karbon të ulët<sup>6</sup>. Strategjia e Kosovës për Energji (SKE), si dokumenti kryesor strategjik dhe udhërrëfyes i zbatimit të direktivave të lartpërmendura, nuk identifikon të gjitha përfitimet, dhe nuk ka ndonjë plan të detajuar për të mobilizuar një fushatë me synim për të nxjerrë në pah këto përfitime për të gjitha palët e interesit (pronarët e ndërtesave, investitorët potencial, bankat etj.) dhe veçanërisht për vendimarrësit. Industria e ndërtimit dhe formalizimi i tregut mund të ndikoj në përmirësimin e BPV-së duke siguruar një fluks të qëndrueshëm punësimi, rritjen e aktivitetit në produkte dhe në shërbime shoqëruese, si dhe të krijoj efekt katalitik në sektorin e ndërtimit si një motor i rëndësishëm ekonomik.

Investimet në rritjen e eficiencës së energjisë mund të kenë edhe efekte tjera indirekte përtej kursimit të energjisë. Këto përfitime zakonisht përfshijnë ruajtjen dhe rritjen e vlerës së patundshmërive, përmirësime estetike të fasadave të ndërtesa të vjetra, ndikimeve pozitive në mirëqenien e njerëzve, uljen e varfërisë energjetike, rritjen e punësimit, rritjen e aftësive të punës dhe integrimin e ekonomisë joformale në sistemin e pagesës së taksave.


<sup>5</sup> Parlamenti Evropian, Direktivat për EE 2021. Burimi: <https://bit.ly/3JifoVw>, qasur më 25.01.2023

<sup>6</sup> Traktati i Energjisë, Studimi në caqet e përgjithshme të vitit 2030 për Komunitetin e Energjisë – Eficiencia e energjisë, BRE, reduktimi i grazrave serë. Burimi: <https://bit.ly/3ZmbRuX>, qasur më 25.01.2023

## 2. Kriza energjetike në Kosovë dhe masat e qeverisë

Sektori i energjisë në Kosovë përfshin prodhimin, transmetimin, shpërndarjen e energjisë elektrike dhe disa termocentralet të ngrohjes qendrore. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike prodhohet nga termocentralet e linjitet, përkatësisht Kosova A dhe Kosova B, me një kontribut të konsiderueshëm nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) të instaluar në vitet e fundit. Kapaciteti i përgjithshëm gjenerues i Kosovës është 1,568 MW, duke përfshirë burimet e ripërtëritshme, por kapaciteti operativ është 1,236 MW, ku termocentralet e linjitet kontribuojnë 77.7% të tij.<sup>7</sup>

**Figura 3.** Prodhimi i energjisë elektrike sipas burimit




Burimi: Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, 2022

Vitet e fundit ka pasur një rritje të lehtë të kapaciteteve gjeneruese për shkak të instalimit të disa burimeve të ripërtrishme. Megjithatë, vetëm prodhimi vendor nuk mund të përmbushë kërkesën maksimale të sistemit elektroenergjetik të Kosovës, e cila plotësohet me importimin e energjisë elektrike. Kapaciteti i përgjithshëm i gjeneratorëve në Kosovë është 1,236 MW, ndërsa pika më e lartë e konsumit për vitin 2021 përgjatë muajit dhjetor ishte 1,398 MW. Si rezultat, raporti i përshtatshmërisë së kapacitetit gjenerues ndaj ngarkesës maksimale në rastin më të mirë kur të gjithë gjeneratorët janë në funksion është 88.4%<sup>8</sup>. Kapaciteti energjetik i Kosovës është jo fleksibil dhe prodhon të njejtën sasi përgjatë gjithë vitit me devijime të vogla nga burimet e ripërtrishme. Kurba e konsumit në Kosovë është më e lartë në muajt e ftohtë të dimrit ku pjesa më e madhe e konsumit elektrik është e përqëndruar në ngrohje të konsumatorët shtëpiakë. Andaj, jo fleksibiliteti në prodhim, konsumi i lartë përgjatë muajve nëntor-mars (shih figurën 4) rezulton në importe të larta të energjisë si dhe krijon ndjeshmëri nga krizat e tregjeve ndërkombëtare në tregun vendor.

<sup>7</sup> ZRRE, Raporti Vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3lShQR4>, qasur më 30.01.2023

<sup>8</sup> Po aty.

**Figura 4.** Konsumi i energjisë elektrike sipas muajit (2021 dhe 2022)

Burimi: Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, 2022

Rritja e çmimit të energjisë elektrike në mbarë Evropën në tetor 2021, e shkaktuar nga rritja e çmimit të gazit nga Rusia, pati një ndikim të lartë edhe në Kosovë. Konsumi joefikas i energjisë dhe mungesa e zhvillimit të kapaciteteve të reja rezultuan në një mungesë të paprecedentë të energjisë. Në dhjetor 2021, termocentralet Kosova A dhe B pësuan prishje dhe ishin jashtë funksionit për kohë të caktuar. Edhe pse Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK) arriti të rikthejë në funksion Kosovën A dhe një njësi të Kosovës B brenda një dite, blloku B2 mbeti jashtë funksioni deri më 23 janar 2022<sup>9</sup>. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, pati një rritje të paprecedentë të çmimeve për shkak të faktorëve të ndryshëm. Kjo rezultoi në rritje të konsiderueshme të çmimeve deri në 376 €/MWh në HUPX – Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike, e cila konsiderohet një pikë referimi për shkak të afërsisë dhe likuiditetit të saj. Vetëm në dhjetor 2021, KEDS dhe KESCO kanë importuar energji elektrike në vlerë prej 32.3 milionë euro.<sup>10</sup> Për shkak të kapaciteteve të kufizuara të brendshme dhe çmimeve të ngritura në tregun evropian të energjisë, Kosova u obligua të bënte rishikimin në tarifën e energjisë elektrike.

Në janar 2022, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) mori vendim për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike për amvisëritë dhe bizneset. Normat e konsumit përfundimtar pothuajse u dyfishuan, duke u rritur nga 6.5 cent/kWh në 12.5 cent/kWh (pas subvencioneve) për konsumatorët që shpenzuan më shumë se 800 kWh. Kjo rritje u pasua nga rritja prej 15% në 2023 për të gjithë konsumatorët<sup>11</sup>. Për të lehtësuar rritjen e çmimeve, qeveria subvencionoi sektorin e energjisë me rreth 120 milionë euro, të cilat iu shpërndanë drejtpërdrejt konsumatorëve nëpërmjet zbritjeve në faturat e tyre finale të energjisë elektrike dhe subvencionimin e importeve. Kjo bëri që rritja e çmimit të mos vihej re për bizneset dhe familjet që konsumonin më pak se 800 kWh në muaj. Përmes kësaj mbështetjeje buxhetore, KEK-u kishte për detyrë blerjen e energjisë nga tregjet ndërkombëtare dhe rishitjen e saj tek furnizuesi dhe distributori në Kosovë.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Kallxo.com. ZRRE vendos për rritjen e të hyrave të KESCO, pritet shtrenjtim i tarifave të rrymës.

Burimi: <http://bit.ly/3rewi00>, qasur më 02.04.2023



Fokusi kryesor strategjik gjatë dy dekadave të fundit ka qenë rritja e pasuksesshme e kapaciteteve të prodhimit të energjisë për të përmbushur konsumin e brendshëm dhe për të kompensuar humbjet e energjisë. Pjesa më e madhe e kërkesës për energji elektrike ndodhë gjatë muajve të pikut të dimrit, ku konsumatorët kryesorë janë amvisëritë. Prandaj, investimi në efikasitetin e energjisë do të ishte zgjidhja më pak e kushtueshme. Një program gjithëpërfshirës i efikasitetit të energjisë do të kishte disa përfitime, duke përfshirë uljen e konsumit të energjisë, përmirësimin e cilësisë së ajrit, uljen e importeve të energjisë, ruajtjen e pyjeve, reduktimin e shpenzimeve të qeverisë për energjinë elektrike, përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, rritjen e punësimit dhe formalizimin e ekonomisë.

### 3. Financimi i projekteve të EE dhe ndikimi në ekonominë e Kosovës

Financimi është elementi kyç në arritjen e objektivave të lartëpërmendura, andaj mobilizimi i të gjitha resurseve (publike dhe private) është mëse i nevojshëm në arritjen e targeteve strategjike. Përgjatë viteve të fundit, Kosova ka zbatuar një numër projektsh në fushën e EE-së, mirëpo këto projekte fokusin kryesor e kanë pasur targetimin e objekteve publike, ndriçimin publik dhe në masë më të vogël industrinë. Ndërsa përgjatë dekadës së fundit, projektet nuk kanë targetuar konsumatorin më të madh të energjisë elektrike, amvisëritë. Investimet në fushën e EE-së janë promovuar me vendosjen e caktimit për EE nga Sekretariati i Traktatit të Energjisë për vitet 2015-2020, në të cilin Kosova është anëtare, rrjedhimisht, ashtu si do të diskutohet në seksionin 3.1, për arritjen e këtij cak, një numër projektsh janë zbatuar në sektorin publik.


Së fundmi, me aprovimin e SKE, qeveria ka vendosur cakun prej 15.7 përqind apo 283 ktoe deri në vitin 2031. Duke u nisur nga supozimi se 6.1 milionë euro (sipas mesatares së investimeve nga projektet ekzistuese) janë të nevojshme për 1 ktoe kursim të energjisë, shkalla e totale e investimit të nevojshëm për të arritur targetet ambicioze prej 15.7 përqind është 322 milionë euro në skenarin më të mirë, dhe tejkalon 366 milionë euro në skenare më të ngadalshme (shih tabelat 4 dhe 5 në aneks). Rrjedhimisht, shkalla e investimeve vjetore të nevojshme për arritjen e targeteve strategjike për vitin 2031 varet nga kurba e investimeve dhe zhvillimi i politikave dytësore, sikurse Plani për zbatimin e SKE-së. Mirëpo, nëse investimi shtrihet njëtrajtësisht sipas propozimit të lartëpërmendur, atëherë është i nevojshëm një investim prej 32–37 milionë euro për vit.

Për arritjen e këtij cak, është i nevojshëm mobilizimi i plotë i sektorit privat, rrjedhimisht, në vitet e para të zbatimit të strategjisë së energjisë, financimi i qeverisë është i nevojshëm për të promovuar dhe rritur zbatimin e këtyre objektivave. Prandaj, një kombinim i financimit të buxhetit të qeverisë, mekanizmat financues të Fondit Kosovar për Efikasitetin e Energjisë (FKEE-së), financimi i donatorëve, dhe fondeve të sektorit privat është më se i nevojshëm për të bërë këto investime më tërheqëse për sektorin privat.

#### 3.1. Investimet në Sektorin Publik përgjatë viteve 2016–2022

Përgjatë viteve 2016–2018, ME në bashkëpunim me komunat dhe Agjencionin Kosovar për Efikasitetin e Energjisë (AKEE) ka zbatuar një numër projektsh në fushat e ndërtesave publike, ndriçim publik, kompanitë e ujësjellësve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto projekte arrijnë kursimin total prej 4.41 ktoe (shih figurën 5)<sup>12</sup>.


<sup>12</sup> Traktati i Energjisë, Raporti i Progresit për EE (2017–2021), Burimi: <https://bit.ly/3oSoAlb>, qasur më 10.04.2023

**Figura 5.** Kursimet ne EE (ktoe) per vitet 2016–2022

Burimi: Raporti i progresit për EE, 2023

Këto projekte janë zbatuar si rezultat i një kredie të butë të siguruar nga Banka Botërore në vlerë prej 5.7 milionë euro, mbështetjes nga Qeveria e Zvicrës (0.25 milion euro), KIESA (Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë) 0.7 milion euro, ndarje e buxhetit të shtetit në vlerë prej 1.9 milion euro, si dhe bashkëfinancim nga komunat përfituese.

Përgjatë viteteve 2018–2020, ashtu siç është paraqitur edhe në figurën 6, ME dhe AKEE kanë vazhduar promovimin e masave të EE-së në sektorin publik, konkretisht në objektet shkollore ku në vitin 2018 janë zbatuar masat në 26 objekte shkollore, në një vlerë totale prej 1.72 milion euro; në vitin 2019 janë zbatuar masat në 19 objekte shkollore, në një vlerë totale prej 1.08 milion euro; dhe në vitin 2020 janë targetuar 27 shkolla, duke rezultuar në një investim prej 1.69 milion euro. I gjithë investimi arrin vlerën prej 4.49 milionë euro dhe kursimin prej afro 1 ktoe (figura 6).

**Figura 6.** Numri i shkollave të renovuara për komunë (2018–2020)

Burimi: Raporti i progresit për EE, 2023

Gjatë vitit 2021, AKEE në bashkëpunim me komunat e Ferizajit, Kamenicës, Prishtinës, Lipjanit, Vitisë, Pejës dhe Prizrenit ka zbatuar masat e EE-së në ndriçim publik, ku investimi total arrinë vlerën prej 2.97 milionë euro dhe kursimin prej 0.4 ktoe<sup>13</sup>.

Edhe gjatë vitit 2022, Kosova ka zbatuar projekte në fushën e EE, kryesisht projekte të cilat janë udhëhequr nga FKEE, ME apo AKEE dhe të cilat kanë pasur fokus direkt sektorin publik. FKEE vazhdoi thirrjet publike për përmirësimin e EE në komunat e Kosovës dhe nënshkroi 73 marrëveshje me 22 komuna, në vlerë prej 9 milionë EUR dhe kursim të vlerësuar prej 1.47 ktoe. Tutje, AKEE ka zbatuar projekte paralele në vlerë prej 0.96 milion euro duke arritur kursim prej 0.17 ktoe<sup>14</sup>.

### 3.2. Investimet në Sektorin Privat përgjatë viteve 2016–2022

Përderisa projektet e udhëhequra nga qeveria ishin të orientuara kryesisht drejt ndërtesave publike, projektet e financuara nga donatorët dhe sektori privat kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e përgjithshme të EE në sektorin privat dhe atë të banimit. Përgjatë viteve 2016–2022, vlerësohet që programe të ndryshme të mbështetura nga bankat komerciale në Kosovë arrijnë kursimin prej 15.91 ktoe. Këto kursime janë regjistruar si rezultat i kredive të gjelbërta që janë financuar nga bankat ndërkombëtare.

Për më tepër, përgjatë viteve 2016–2022, Projekti i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) nëpërmjet programit Fondacioni i Mijëvjeçarit Kosovë (MFK) ka mbështetur:

- 962 shtëpi individuale me një kosto totale investimi prej 7.7 milionë dollarë (7.19 milionë euro).
- 643 familje në ndërtesa shumëbanesore me një kosto totale investimi prej 5.5 milionë dollarë (5.14 milionë euro).
- 2.3 milionë dollarë investime për gratë në biznes (2.15 milionë euro).

Ky projekt nëpërmjet granteve të pjesshme ka arritur të promovoj bashkëfinancim nga sektori privat në zbatimin e masave të EE-së ku investimi total ka arritur koston prej 20 milionë euro dhe kursim prej 3.2 ktoe<sup>15</sup>. Për më tepër, ka krijuar një precedentë në mbështetjen e sektorit privat për zbatimin e masave të EE-së.

Në vitin 2022, përmes fondit prej 6 milionë eurosh, ME ka hapur thirrjen e mbështetjes së paisjeve elektrike për ngrohje (klíma efiçiente, pompa termike etj.) dhe ka arritur të mobilizoj sektorin privat/rezidencial në bashkëfinancim të produkteve ku është arritur një investim total prej 15 milionë eurosh dhe kursime afër 2.5 ktoe.

Rrjedhimisht, qeveria përmes ME, MFPT dhe FKEE është duke zbatuar masat e EE-së që targetojnë sektorin privat dhe ulin barrën e krizës energjetike te ekonomitë familjare. Këto masa financohen nga riprogramimi i fondeve të programit IPA 2023 (Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit), ku qeveria ka përfutur 75 milionë euro mbështetje direkte në buxhet. Nga to, 40 milionë euro do të jenë ndihma direkte për konsumatorët në nevojë dhe për konsumatorët të cilët kursejnë energji në krahasim me vitet paraprake. Ndërsa 35 milionë euro do të distribuohen tek konsumatorët të cilët investojnë në EE. Këto masa parashohin të mbështesin adoptimin e paisjeve të reja efiçiente elektro-shtëpiake si dhe sistemet solare dhe paisje për ngrohje. Rrjedhimisht, parashihen investime në sektorin privat (fokus kryesor ndërmarrjet mikro dhe të vogla) si dhe ekonomitë familjare/sektori rezidencial.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Fondacioni i Mijëvjeçarit Kosovë. Burimi: <https://bit.ly/3ZphRD6>, qasur më 10.02.2023

**Tabela 1.** Masat e EE-së të dizajnuara pas mbështetjes nga BE-së

Masa	Buxheti	Fushat e ndikimit	Kursimi i pritur
Mbështetja e konsumatorëve individualë familjarë, duke përfshirë konsumatorët në nevojë, duke rritur efikasitetin energjetik të njësive të banimit dhe ndërtesave	20 milionë euro	Renovimi i njësive të banimit, zbatimi i masave të EE-së duke përfshirë mbështjellësin, dyer/dritare, sisteme të ngrohjes, izolimin e kulmit etj.	6.54 ktoe
Mbështetja e konsumatorëve individualë familjarë, duke përfshirë konsumatorët në nevojë, për të investuar në pajisje shtëpiake me efikasitet energjetik dhe sisteme të energjisë së rinovueshme	10 milionë euro	Paisje elektro-shtëpiake duke përfshirë sistemet e ngrohjes/ftohjes, sisteme solare etj.	3.28 ktoe
Stimulimi i kursimeve të energjisë nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME)	5 milionë euro	Paisje të punës duke përfshirë sistemet e ngrohjes/ftohjes, sisteme solare etj.	1.64 ktoe
Potenciali total për kursim	11.47 ktoe		

Burimi: Ministria e Ekonomisë, skemat mbështetëse

Përderisa masat e EE-së nuk janë publikuar si të plota, kalkulimi i saktë i ndikimit të masave është më i vështirë. Mirëpo, në rast se aplikohet praktika e zhvilluar nga masat paraprake ku kërkohet bashkëfinancim nga sektori privat dhe rezidencial, ky investim mund të ndikoj në një kursim total prej 11.47 ktoe apo 133,396.1 MWh<sup>16</sup>. Në rast se kjo energji do të improtohej përgjatë viteve stabile të tregut të energjisë (85 euro/MWh) do të shkaktonte kosto shtesë për qytetarët në një vlerë totale prej 11.4 milionë euro dhe në rast se importohet përgjate periudhave të krizave (mbi 300 euro/MWh), kursimi mund të arrij në 40 milion euro në vit. Andaj, duke investuar në këto masa, ME do të promovoj rritjen ekonomike, zvogëlimin e papunësisë, stabilitetin e sistemit energjetik, si dhe kthimi i investimeve publike do të jetë brenda tre viteve.

Si rrjedhojë, në rast se mbështetja e institucioneve prej 120 milionë euro përgjatë krizës energjetike do të orientohet me kohë drejt investimeve në EE dhe BRE, ndikimi i kësaj krize në sektorin e energjisë do të ishte shumë më i vogël.

## 4. Strategjia e Energjisë, legjislacioni dhe objektivat strategjike

Konsumi primar i energjisë është rritur me një mesatare vjetore prej 1.4% ndërmjet viteve 2008 dhe 2020. Norma e rritjes u moderua në fund të dekadës, por u ndikua po ashtu nga efektet afat-shkurtëra (pandemia COVID-19), prandaj, një ngritje e shpejtë e konsumit është paraparë edhe në vitet në vijim. Konsumi final i energjisë ka pasur një trend të njëjtë në këtë periudhë, me normë të ngritjes mesatare vjetore prej 2.3%, duke arritur 1,525 ktoe në 2020. Edhe pse intensiteti i energjisë në Kosovë është përmirësuar dukshëm nga viti 2008, ende është shumë i lartë krahasuar me mesataren e BE, por gjithashtu më i lartë se mesatarja e shteteve në regjion.

Përveç Strategjisë së Energjisë, Kosova ka adoptuar ligjet dhe aktet nënligjore të nevojshme duke përfshirë Ligjin për Efikasitet të Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Ngrohje, dhe Ligjin për

<sup>16</sup> Grupet punuese për dizajnimin e skemave për EE, Janar 2023.

Përformancën Energjetike të Nërtesave. Aktivitetet për të përforcuar ekspertizën dhe mjetet për certifikimin e ndërtesave janë duke u zhvilluar, përfshirë një regjistër të ri dhe softuerin për certifikim. Disa aktivitete janë duke u zhvilluar me qëllim të zgjerimit të financimit për sektorin rezidencial dhe privat. Sidoqoftë, rregullat dhe rregulloret në prokurimin publik të efijencës së energjisë, kompanitë për shërbime energjetike (ESCO) dhe performancës energjetike dhe kontratat për furnizim ende nuk janë finalizuar dhe zbatuar, edhe pse legjislacioni primar dhe shumica e legjislacionit sekondar është adoptuar.<sup>17</sup>

Efijencia e energjisë qëndron si element vendimtar në zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2022–2031. Duke zbatuar këto dokumente strategjike qeveria mund të: zbusë kërkesën për energji, reduktojë varshmërinë nga importet, reduktojë emetimet e gazrave serë dhe të ngrisë përbalueshmërinë në aspektin afatgjatë për konsumatorët.

Objektivat strategjike të shtetit kanë për qëllim uljen e konsumit të energjisë dhe intensitetit të energjisë duke promovuar zhvillimin ekonomik dhe tranzicionin e gjelbër. Caqet janë caktuar nga një studim regjional "Projeksioni i konsumit të energjisë dhe potenciali i kursimit të energjisë në Kosovë deri në 2030", referuar si skenari i BE<sup>18</sup> i bërë nga Komuniteti i Energjisë dhe janë përshtatur formalisht nga Këshilli i Ministrave vitin e kaluar. Caku i përgjithshëm për efijencë të energjisë është kufizimi i konsumit final të energjisë në 1,877 ktoe në vitin 2031.<sup>19</sup>

Arritja e këtij caku të synuar është ekuivalent me një kursim prej 22% krahasuar me projektet e modeluara të studimeve të KE të vitit 2007, apo 15.7% kursim krahasuar me projeksionin bazë të konsumit të energjisë të studimit e BE-së (2,226 ktoe).

Objekivi strategjik i ngritjes së efijencës së energjisë është i ndarë në dy objektiva specifike të cilat përfshijnë efijencën e energjisë në ndërtesa dhe promovimin e bashkëprodhimit (kogjenerimit) efijent dhe sistemeve efijente të ngrohjes. Përmirësimi i efijencës së energjisë në sektorët e industrisë dhe transportit është lënë jashtë strategjisë, me arsyen se do të adresohet përmes dokumenteve të tjera strategjike.

**Tabela 2.** Objektivat strategjik të efijencës së energjisë

Indikatorët: Strategjik Objektivi 3	Projeksioni bazë	Caku për 2024	Caku për 2031
Niveli i konsumit final të energjisë	1,516 ktoe [2017]	1,709 ktoe	1,877 ktoe
Kursimet kumulative të energjisë në sektorin e ndërtimit	2.7 ktoe [2021]	26.6 ktoe	283 ktoe

Burimi: Strategjia e Energjisë 2022–2031

Përmes Strategjisë së Energjisë, Qeveria ka caktuar objektivat për përmirësimin e efijencës energjetike të ndërtesave dhe promovimin e efijencës përmes kapaciteteve të sistemeve të ngrohtoreve qëndrore. Për të arritur këto caqe, qeveria duhet të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme kornizën dhe programin aktual të politikave. Aktualisht strategjia nuk arrin të adresojë programe dhe politika specifike me supozimin se ato do të përpunohen më tej në planin e veprimit<sup>20</sup>.

<sup>17</sup> Ministria e Ekonomisë, Udhëzimet Administrativ për shërbimet e energjisë (ESCO). Burimi: <https://bit.ly/3T6PtU5>, qasur më 28.01.2023,

<sup>18</sup> N.Bizard (2019): parashikimi i konsumit të energjisë dhe potenciali i kursimit të energjisë në Kosovë deri në vitin 2030, Raporti Final, qasur më 28.01.2023

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Qeveria e Kosovës, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022 – 2031, Burimi: <http://bit.ly/3ZfTwQ1>, qasur më 28.01.2023

Duke parë natyrën e caqeve kumulative ku kursimet e hershme kalkuloohen ndër vite dhe kanë ndikim më të madh, një zhvillim i shpejtë i politikave dhe programeve është i një rëndësie të madhe. Për çdo vit që kalon rritet kurba e investimeve në mënyrë drastike dhe nevojiten më shumë mekanizma financues për të arritur caqet e vitit 2031.

Tabela 3 dhe 4 në aneks na jep një kuptim më të mirë se çfarë duhet bërë për të zbatuar objektivat strategjike dhe domosdoshmërinë për të zbatuar masat shpejt, në mënyrë që kurba e arritjes së objektiveve të rrafshohet. Duke pasur parasysh natyrën e raportimit dhe kalkulimit të këtyre targeteve, investimi i hershëm dhe kalkulimi i kursimeve ndër vite mundëson një investim më të vogël në vitet e fundit.

#### 4.1. Ndikimi i investimeve në efikasitet të energjisë në punësim dhe formalizim të tregut

Shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë prej 20.7% u përkeqësua më tej nga ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës. Shkaqet e shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë janë të shumëta, duke përfshirë mundësitë e kufizuara ekonomike, investimet e pamjaftueshme, sistemet e dobëta të arsimit dhe trajnimit, dhe jostabilitetin politik. Ekonomia e vogël dhe e pazhvilluar e Kosovës, së bashku me burimet dhe infrastrukturën e saj të kufizuara, e bënë sfidues krijimin e mundësive të mjaftueshme formale të punësimit për të përmbushur kërkesën për punësim. Shqetësuese është shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë, ku 55% e individëve të moshës 15 deri në 24 vjeç janë të papunë<sup>21</sup>.

Përfitimet e investimeve në efikasitet të energjisë shkojnë përtej rritjes së komoditetit të jetesës, uljes së varfërisë energjetike dhe mjeteve që injektohen për ngritjen e aktivitetit ekonomik. Këto projekte kanë kapacitet për të mbështetur mijëra familje përmes punëve direkte, indirekte dhe të nxitura. Sipas metodologjisë IMPLAN e cila kalkulon ndikimin e një aktiviteti të caktuar ekonomik në punësim, në rastin tonë ndikimin e zbatimit të masave për efikasitet të energjisë në punësim, do të kemi më shumë njerëz të punësuar në sektorët e ndërtesave dhe rinovimit dhe kjo do të ketë ndikim edhe në rritjen në punësim edhe në sektorët e përafërt<sup>22</sup>. Për shembull, investimi në zëvendësimin e dritareve me ato më efikasitet do të krijojë punësim në ato kompani (punësim i drejtpërdrejtë me kohë të plotë), i ndjekur nga një rritje punësimi në kompanitë që prodhojnë plastikë dhe materiale të tjera të ngjashme (punësim indirekt me kohë të plotë), dhe si rezultat i rritjes së punësimit për përfituesit direkt dhe indirekt dhe rritjes së mjeteve në dispozicion, do të krijohen më shumë vende pune në industrinë e tjera si p.sh. restorante, hotele, dyqane etj.


Sipas një studimi, investimet në EE janë të ndara kryesisht në tri fusha, atë rezidencial, komercial dhe industrial. Ky studim analizon të gjithë nënsektorët e EE-së, dhe tregon që ndikimi direkt në punësim është më i madh në rastet e investimit në sektorin rezidencial<sup>23</sup>. Sipas indikatorëve të përdorur për analizimin e vendeve të reja të krijuara, arsyeja e këtij diferencimi është puna intensive manuale e kërkuar për instalimin e këtyre paisjeve. Vlenë të theksohet se në të trija rastet, ndikimi në punësimin direkt është më i vogël se ato të nxitura. Kjo rrjedhë si pasojë e efektit domino që plasimi i parave ka në ekonomitë familjare.

21 ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë, 2021. Burimi: <https://bit.ly/42ecybb>, qasur më 01.04.2023

22 Brown et al. Vlerësimi i punësimit nga investimet në efikasitet të energjisë. Burimi: <https://bit.ly/3mkoHei>, qasur më 01.02.2023

23 Po aty.

**Figura 7.** Ndikimi i investimeve në EE në krijimin e vendeve të punës për investimin prej 322 milion euro sipas sektorëve (Industrial, Rezidencial dhe Komercial).



Ashtu siç e tregon edhe figura 7, dhe sipas metodologjisë IMPLAN, vlerësohet se për investimin total prej 322 milionë eurosh do të krijohen rreth 4,000 vende pune neto, duke përfshirë ato direkte, indirekte dhe të nxitura. Rrjedhimisht, rreth 12.5 vende të reja pune neto do të krijohen për secilin milion euro të investuar apo 3.7 vende të punës direkte, 3.8 indirekte dhe 5 të nxitura<sup>24</sup>. Sipas kësaj metodologjie, investimet në të tre sektorët (rezidencial, industrial dhe komercial) kanë ndikim relativisht të barabartë në krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, këto përllogaritje nuk marrin parasysh numrin e vendeve të punës të krijuara për shkak të kapitalit të kursyer përmes zbatimit të masave të EE, veçanërisht në sektorët komercial dhe industrial, ndikimi i të cilëve supozohet të jetë i dukshëm.

Rrjedhimisht, sipas studimit të Këshillit Amerikan për Eficiencë të Energjisë (shkurtesa ang.: ACEE), investimet në EE mund të nxisin krijimin e rreth 7 vendeve neto pune për secilin milion euro të kursyer si rezultat i masave të EE-së. Këto vende pune krijohen si rezultat i kapitalit të kursyer nga faturat elektrike dhe ri-distribuirimin e këtij kapitali të kursyer në investime të tjera sikurse rritjen e numrit të punonjësve, zgjerimin e prodhimit tek kompanitë prodhuese, apo shpenzime të tjera<sup>25</sup>. Andaj, me arritjen e cakut prej 283 ktoe (apo kursimin prej 3,291,290 MWh) sipas çmimit minimal prej 60 euro/MW, Qeveria e Kosovës mund të nxisë deri në 1,382 vende pune për një afat kohor prej 20 vite, aq sa vlerësohet jetëgjatësia e masave të EE-së.

24 Brown et al. Vlerësimi i punësimit nga investimet në eficiencë të energjisë. Burimi: <https://bit.ly/3mkoHei>, qasur më 01.02.2023

25 ACEEE, Si eficienta e energjisë krijon vende pune. Burimi: <https://bit.ly/44qCNMM>, qasur më 01.02.2023

**Tabela 3.** Përfitimet nga zbatimit i masave të EE-së

	Kursimi energjetik/ vit	Kursimi nga importi për 20 vite (euro)	Numri i vendeve të punës përgjatë implementimit të projekteve	Numri i vendeve të punës afatgjate (20 vite)
Përfitimet nga zbatimi i masave të EE-së	329,129 MWh (28.3 ktoe- 10 vitet e para) dhe 697,800 MWh (60 ktoe-20 vitet pasuese).	616 mil.	4,000	1,382

Ndërsa SKE 2022–2031 trajton shkurtimisht fuqinë punëtore përmes Objektivit specifik 4.3: "Ngritja e kapaciteteve në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave", ky objektivi specifik nuk është plotësisht i përcaktuar, duke targetuar në mënyrë specifike vetëm Auditorët e Energjisë. Përderisa domosdoshmëria e Auditorëve të Energjisë është e pamohueshme, duhet të ketë edhe programe të tjera që synojnë profesionet e tjera sikurse certifikuesit e energjisë, inspektorët e tregut, inxhinierët e energjisë etj. Për më tepër, SKE duhet të targetoj edhe profesionet e nivelit të mesëm dhe të ulët, si p.sh. ofruesit e shërbimeve (instaluesit) duke përfshirë BRE-të, prodhuesit e pajisjeve me efikasitet energjetike, servisesit e teknologjive të reja, etj.

Përveç krijimit të një sektori krejtësisht të ri punësimi (sektori i gjelbër), qeveria përmes programeve të efikasitetit të energjisë do të jetë në gjendje të krijoj kushtet për formalizimin e tregut, financimin e sektorit privat dhe sigurimin e cilësisë për shërbimet/produktet e ofruara.

Kjo dukuri ka qenë shumë e dukshme përgjatë raundit të fundit të granteve, ku përmes skemës së EE-së për pajisjet efikase qeveria ka targetuar ekonominë shtëpiake dhe teknologjitë e ngrohjes. Përmes fondit prej 6 milionë eurosh, ME ka arritur të mobilizoj sektorin privat/rezidencial në bashkëfinancim të produkteve ku është arritur një investim total prej 15 milionë eurosh dhe kursime afër 2.5 ktoe, të cilat janë qarkulluar përmes kanaleve formale të tregut të punës. Për shkak të kërkesave (dorëzimi i faturës përfundimtare përmes sistemit E-Kosova) qeveria motivoi bizneset e reja që të dalin në tregun formal dhe të ofrojnë shërbimet e tyre për më shumë se 9,000 ekonomi familjare.

Rezultate të tilla janë parë në projektin e MCC/MFK, ku përfitimet nga ky projekt janë të dukshme veçmas në krijimin e precedentit të partneritetit me sektorin privat, si dhe formalizimin e tregut të punës nëpër sektorë. Ky projekt ka arritur të trajtojë 133 ofrues të shërbimeve të lartëpërmendura. Gjithashtu, ka ndihmuar angazhimin e grave në tregun e punës në sektorin e ndërtimit. Duke pasur parasysh përvojën e marrë, këto kompani janë të gatshme të zbatojnë më tej projekte të ngjashme në të ardhmen.



## Rekomandimet

Pavarësisht objektivave shumë ambicioze, legjislacionit të përmirësuar dhe potencialit të madh të kursimit të energjisë, tregu i EE është ende në hapat fillestar. Ky zhvillim i ngadalshëm vjen si rezultat i shumë barrierave, që përfshijnë ndërgjegjësimin e sektorit privat dhe kërkesën e kufizuar të tregut, mungesën e ofertave nga institucionet financiare si dhe mungesën e kompanive ESCO.

Për zbatimin e suksesshëm dhe kost-efektiv të tranzicionit energjetik është e nevojshme investimi në gjenerim nëpërmjet BRE-ve dhe ulje të kërkesës energjetike nëpërmjet EE-së. Investimi në EE jo vetëm do të ndihmojë në arritjen e objektivave të vendosura nga BE, mirëpo edhe do të rrisë kualitetin e jetesës së qytetarëve të Kosovës, ulë varfërinë energjetike, rritë pavarësinë dhe sigurinë shtetërore, zvogëlojë papunësinë dhe rrisë aktivitetin ekonomik. Rrjedhimisht, për arritjen e këtyre qëllimeve, qeveria duhet të hartoj dhe zbatoj një plan veprimi gjithëpërfshirës.

Për të promovuar eficientë e energjisë në sektorin privat, Qeveria e Kosovës duhet të ndër marrë veprimet e mëposhtme:

- të siguroj rrjedhën e vazhdueshme të financimit në Fondin e Eficientë së Energjisë nëpërmjet zbatimit të skemave të detyrueshme, sipas Ligjit për Energjinë. Nëpërmjet kësaj skeme, çdo kompani energjetike është e detyruar të investojë një pjesë të fitimit për zhvillimin e masave të Eficientë së Energjisë tek palët e treta.
- të zgjeroj fushëveprimin e Fondit të Eficientë së Energjisë duke e bërë atë fond për tranzicionin energjetik i cili ka mandat të mbështesë ekonominë familjare, sektorin privat, si dhe sektorin publik në zbatimin e masave të eficientë së energjisë.
- të krijoj tregun e kompanive ESCO, duke zhvilluar model kontratat<sup>26</sup> që të sigurohet investimi i tregut privat në projektet e Eficientë së Energjisë.
- të zgjeroj mbështetjen e Fondit për Garanci Kreditore në mbështetje të sektorit privat për uljen e riskut në investimin e projekteve të EE-së.
- të zhvillojë strategjitë plotësuese që promovojnë eficientë e energjisë në sektorët e transportit dhe industrisë.

Për më tepër, qeveria duhet të vazhdojë të zbatojë programet e saj në mbështetje të komunave në zbatimin e masave për EE në ndërtesat publike si dhe të mbështeten komunat në zbatimin e projekteve vetanake me mbështetje financiare nga institucionet ndërkombëtare, që të përmisojnë më tej agjendën e tyre të gjelbër.

Së fundi, në përgatitje të zbatimit të SKE-së, qeveria dhe partnerët e saj vendorë/ndërkombëtarë duhet të fillojnë përgatitjen e tregut të punës dhe tregut në përgjithësi për të rritur kapacitetet absorbuese, duke ulur rrezikun e rritjes së inflacionit të shërbimeve të lartpërmendura dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve/produkteve.

<sup>26</sup> Kontrata të zhvilluara nga ME/AKEE dhe përfshijnë praktikën më të mira për kontraktimin e shërbimeve ESCO duke garantuar kursimet e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë.

# Aneksi

**Tabela 4.** Skenari 1 për arritjen e cakut të EE-së

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	
Kursimet vjetore (ktoe)	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	X	5.5	5.5	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	X	X	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	2.7	8.9	15	20.4	25.8	31.2	36.6	42	47.5	52.9	283

**Tabela 5.** Skenari 2 për arritjen e cakut të EE-së

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	
Kursimet vjetore (ktoe)	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	8	8	8	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	X	9	9	
Kursimet vjetore (ktoe)	X	X	X	X	X	X	X	X	X	8.5	
Kursimet vjetore (ktoe)	2.7	7.8	12.9	18.3	23.7	29.1	34.5	42.5	51.5	60	283

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.


[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)

Instituti GAP përkrahët nga:



**Përfitimet ekonomike nga  
investimet në eficiency  
të energjisë në Kosovë**